



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo  
Komuna Hani i Elezit- Municipality of Elez Han



02/Nr. 5680 /2026

25.06.2026

Në bazë të Ligjit për Zyrarët Publikë Nr.08/L-197 në nenin 78 paragrafi 2, neni 80 dhe 81, Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8 Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021 dhe 01/2022, Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Rregullore (QRK) nr.19/24 Për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, Komuna Hani i Elezit shpallë:

### KONKURS

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës me kohë të pacaktuar)

**Institucioni:** Komuna Hani i Elezit

**Drejtoria:** Drejtoria për Arsim

**1.Titulli i vendit të punës:** Mësimdhënës/e për Arsim Fillor

**njësia/ sektori:** SHFMU "Ilaz Thaçi"-paralelja Seçishtë

**Numri i pozitave:** Një (1) pozitë me kohë të pacaktuar

**Koeficienti/Grada:** E19-6.60

**Orët e punës:** 20 orë

#### Detyrat dhe përgjegjësitë për Mësimdhënës/e :

Të realizoj planprogramin mësimor për vendin e punës , në harmoni me legjislacionin në fuqi, që të rregullojë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;

Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;

Të përgadit me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;

Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe vlersimit në përputhje me me Udhëzimet Kurikulare;

Të mbajë ditarin personal të vlersimit të nxënësve.

Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës;

Të respektoj autoritetin e drejtpërdrejt të zyrarit , të cilit i raporton dhe ti kryej detyrat që mund ti caktoj ai/ajo.Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

#### Kushtet e përgjithshme në rekrutim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë e/i denuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Të mos ketë fuqi masë disiplinore për shkelje të rendë në institucion publik

### **Kualifikimi për Arsim Fillor**

Fakulteti i Edukimit-programi fillor;  
-Fakulteti i Mësuesisë;

### **Dokumentet e nevojshme:**

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezymeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje ).
- Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jete kopje të vërtetuara.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (nga gjykata )
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).
- Çertifikatën shëndetësore (pas pranimit në punë).

### **Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:**

-Procedura e vlerësimit bëhet sipas Rregullorës (QRK) nr.19/2024.

### **Afati dhe mënyra e aplikimit:**

**Pranimi i aplikacioneve bëhet mbrenda tridhjetë ( 30) ditëve nga data 26.06.2026 deri 25.07.2026 nga ora 08:00-16:00**

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në fazat jera do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirëpriten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës.

**Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.**

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>, në web faqen e komunës <https://haniielezit.rks-gov.net/> tabelën e shpalljes.



Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi